



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



Anr.612/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada- Glllogjani kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e subjektit politik SDU –Socijaldemokratska Unija, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive lidhur me caktimin e Komisionerëve në Vendvotime në Komunën e Prizrenit, për Zgjedhjet Lokal 2021, e që do të mbahen më 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 11.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET i palejuar apeli Anr.612/2021 i datës 08.10.2021 i paraqitur nga subjektit politik SDU –Socijaldemokratska Unija, kundër vendimit me nr. 2292-2021 i datës 14.09.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive lidhur me caktimin e Komisionerëve në Vendvotime në Komunën e Prizrenit, për Zgjedhjet Lokal 2021.

A r s y e t i m

Me datën 08.10.2021, PZAP-i ka pranuar një apel nga subjektit politik SDU – Socijaldemokratska Unija, me të cilën pretendon se në bazë të vendimit të marrë nga ana e KQZ-së, në Prishtinë, me datë 14.09.2021, partia SDU –Socijaldemokratska Unija, kanë pasur të drejtë për ndarjen e komisionerëve në proporcion me partitë e tjera nga komuniteti Boshnjak (DSB dhe NDS). Gjithashtu në apelin e parashtruar ka theksuar se kanë pranuar e-mail zyrtar nga KQZ komunale në Prizren, (aludohet për KQZ Prizren) nga Nysret Bytyqi, ku shihet se kanë vendosur kundër vendimit të KQZ-së, i cili është marrë me datë 14.09.2021. Sipas vendimit që është marrë nga ana e KQZ-së në Prishtinë, të cilën e ka votuar KQZ-ja të gjitha partitë Boshnjake të kenë ndarjen e barabartë të komisionerëve në Komunën e Prizrenit. Prej 221 vendvotimeve në Prizren që janë të gjitha, parashtruesi i apelit thekson se ne kemi kërkuar që ku janë vendvotimet boshnjake të kemi në çdo vend komisionarë.

Apelit ia ka bashkangjitur vendimin e KQZ-së, për Miratimin e Rekomandimit dhe Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve për Zgjedhjet Lokale

Në përgjigjen e KQZ-se theksohet se ankesa është e pasafatshme sepse me date 14.09.2021, KQZ ka miratuar rekomandimin e Këshillit për Operacione Zgjedhore, për numrin dhe përbërjen e KVV-ve për Zgjedhjet Lokale 2021. Kurse ankesa e subjektit politik ne fjalë, është bërë me datë 08.10.2021, qe i bie pas njëzet e katër (24) ditësh dhe si rrjedhojë e kësaj, kjo

ankesë është e pasafatshme bazuar në nenin 13 të Ligjit për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli, pasi që vlerësoj lejueshmërinë e apelit konstatoj se:

Apeli është i pa lejuar

Me nenin 63 paragrafi 3 i LZP-së, përcaktohet se: *“Vendimi i Komisionit nuk i nënshtrohet ankesës, përveç nëse nuk parashihet qartë me këtë ligj”*.

Me nenin 64 paragrafi 2 pika a) i LZP-së, përcaktohet se: *“KQZ-ja i përgatitë dhe shpall rregullat, format dhe procedurat zgjedhore që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji dhe me çdo çështje tjetër që ka të bëjë me drejtimin e zgjedhjeve në kuadër të kompetencës së saj”*, ndërsa me pikën b) të këtij neni përcaktohet se: *“KQZ-ja, i publikon të gjitha rregullat e miratuara, udhëzimet dhe procedurat zgjedhore dhe i bënë ato të arritshme për opinionin”*.

Apelimet zgjedhore ndaj vendimeve të KQZ-së, në PZAP, janë përcaktuar me nenin 122 paragrafi 1 pikat: a) b) c) d) e) dhe f) të LZP-së, në të cilat përcaktohet se:

- a) Përfshirjen ose largimin e një personi për të marr pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës;
- b) Certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje;
- c) Kandidati i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;
- d) akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor;
- e) vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji dhe
- f) Refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës.

Nga interpretimi i dispozitave të lartcekura rezulton se vendimet e tilla të KQZ-së, nuk janë të apelueshme përveç nëse parashihen qartë me ligj. Në këtë rast vendimi i apeluar i KQZ-së, nuk hynë në kategorinë e vendimeve të cilat mund të apeloohen e të cilat janë të përcaktuara si më lartë.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 118 të LZP-së dhe nenin 11 paragrafi 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 612/2021 më datën 11.10.2021.

Kryesuese e Panelit
Afijete Sada-Gollogjani

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.

